



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit
të Përgjithshëm Vlorë**

Numri i Çështjes	23000-00695-61-2025	Data e Regjistrimit	02/05/2025
Numri i Vendimit	61-2026-2587	Data e Vendimit	15/06/2026

**VENDIM
NE EMER TE REPUBLIKËS**

**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë
E PERBERE nga:**

KRYESUES: Ertil Meçaj

ANËTAR

SEKRETARE Samanta Xhindi

Objekti: 1.Shpallja i zhdukur i shtetasit Elvis *****, I biri I Krenar dhe *****, I datelindjes 03.06.1994 lindur dhe banues ne *****.
2.Caktimin si kujdestar te pasurise/pasurive te shtetasit Elvis *****, shtetasen *****

Baza Ligjore : Neni 15-16 I k.Civil, neni 375 e vijues I K.Pr.Civile

Përmbledhja e vendimit:

x

Vëren:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM
VLORE**

**Nr. Regj.Them. 552 (23000-00695-61-2025)
281 (61-2025-2587)**

Numër Vendimi

**Datë Regjistrimi 02.05.2025
15.06.2026**

Datë Vendimi

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, e përbërë nga:

Kryesues: Ertil Meçaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit
të Përgjithshëm Vlorë**

Anëtare: Alba Ngresi

Anëtar: Etien Isak

Asistuar nga sekretare gjyqësore **Ina Zahaj**, në Vlorë, sot më datë 15.06.2026, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, çështjen civile Nr.Regj.Them. 552 (23000-00695-61-2025), Datë Regjistrimi 02.05.2025, që i përket:

Kërkues:

*****, atësia *****, amësia Nadire, datëlindja 17.07.1972, vendlindja Vlorë, vendbanimi lagjja "29 Nëntori". Përfaqësuar me prokurën e posaçme nr. 1116 rep, nr.620 kol., datë 09.04.2025, nga Av. Esli Dhimojani, numër 9913 license, NUIS, M26531201J, dhe Av. Ariton Kasaj, numër 7486 license, NUIS L54502204F, anëtarë të Dhomës së Avokatisë Vlorë *(jo prezent në shpalljen e vendimit)*.

Person i tretë:

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, përfaqësuar nga Prokuror Julinda Gjika *(jo prezent në shpalljen e vendimit)*.

Objekti:

1. Shpallja i zhdukur i shtetasit Elvis *****, atësi Krenar, amësi *****, datëlindja 03.06.1994, lindur dhe banues në Vlorë.

2. Caktimin si kujdestar të pasurisë/pasurive të shtetasit Elvis *****, shtetasen *****.

Baza ligjore:

Nenet 15 - 16 të Kodit Civil. Nenet 375 - 381 së Kodit të Procedurës Civile.

Gjykata, pasi i dha fund hetimit gjyqësor të çështjes, si dëgjoji përfaqësuesin e palës kërkuese Av. Ariton Kasaj, i cili në pretendimet e tij



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë

përfundimtare, kërkoi pranimin e kërkesës sipas objektit, përfaqësuesin e personit të tretë, Prokuror Julinda Gjika, e cila kërkoi pranimin e kërkesës, si dhe pasi vlerësoi në tërësi provat e marra në respektim të rregullave të gjykimit civil,

VËREN:

I. Procedura

Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë në datë 02.05.2025 është paraqitur nga pala kërkuese, kërkesa civile me objekt: *"1. Shpallja i zhdukur i shtetasit Elvis ***** , atësi Krenar, amësi ***** , datëlindja 03.06.1994, lindur dhe banues në Vlorë. 2. Caktimin si kujdestar të pasurisë/pasurive të shtetasit Elvis ***** , shtetasen *****"*.

Me shortin elektronik të datës 02.05.2025, çështja civile Nr.Regj.Them. 552 (23000-00695-61-2025), Datë Regjistrimi 02.05.2025 i është caktuar për gjykim Gjyqtar Ertil Meçaj.

Gjykata kryesisht, nisur nga objekti dhe shkaku ligjor i kërkesës, në mbështetje edhe të neneve 36, 41 dhe 375 e vijues të KPC, vlerësoi se shqyrtimi i saj i përket juridiksionit gjyqësor dhe është në kompetencë lëndore dhe tokësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë. Ndërkohë, bazuar në nenin 35/2, gërma "c", të KPC, gjykimi i çështjes u zhvillua me trupë gjykuese të përbërë nga 3 (tre) gjyqtar.

Përsa i përket legjitimitetit procedural, Gjykata vëren se pala kërkuese ***** , në bazë të neneve 31 dhe 375 të KPC, në cilësinë e "personit të interesuar", legjitimohet "prima facia", t'i drejtohet Gjykatës, nëpërmjet kërkesës objekt gjykimi. Referuar provave shkresore të administruara në gjykim, certifikatës familjare, datë 28.04.2025 të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Nr. 417, Njësia Administrative Vlorë, Bashkia Vlorë, rezulton se kërkuesia ***** është nëna e shtetasit Elvis ***** . Në këto kushte, ky subjekt, në cilësinë e "*personit të interesuar*", legjitimohet në paraqitjen e kërkesës për shpalljen e zhdukur të shtetasit Elvis ***** .

Së fundi, Gjykata në vështrim të neneve 71, 72 dhe 73 të KPC, çmoi se nuk ekzistojnë për të shkaqe papajtueshmërie ose përjashtimi nga ky gjykim. Ky fakt, në vijimësi të procesit, mbeti i pa kundërshtuar nga palët pasi këto u njohën me përbërjen e trupit gjykues.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë

Me vendimin datë 12.05.2025, *“Për thirrjen e personit të trete”*, gjykata në zbatim të neneve 4, 192, 194 dhe 375 e vijues të KPC, vendosi të thërrasi me cilësinë e personit të tretë Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë.

Gjykata, me vendimin e ndërmjetëm, datë 12.05.2025 për *“Për veprime paraprake”*, në refeim të nenit 377 të Kodit të Procedurës Civile, brenda 10 ditëve nga paraqitja e kërkesës disponoi: *“1. Njoftimin e kërkesës dhe një kopje të provave të paraqitura nga pala kërkuese, Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë. 2. Një kopje e kërkesës i dërgohet Bashkisë Vlorë për shpallje në një vend publik. 3. Kërkesa të publikohet në Fletoren Zyrtare dhe një prej gazetave lokale, në mungesë të një gazete lokale, të bëhet publikimi në një gazetë kombëtare. 4. Shqyrtimi i kërkesës nga gjykata do të bëhet pasi të kenë kaluar të paktën gjashtë muaj nga shpallja e kërkesës ose botimit të saj në Fletoren Zyrtare”*.

Kërkesa për shpallje i zhdukur të shtetasit Elvis ***** me shkresën e datës 12.05.2025 është dërguar për shpallje pranë Bashkisë Vlorë. Gjithashtu kërkesa është shpallur në gazetën “Panorama”, në datë 27.05.2025, sipas shkresës nr. 20/1 prot., datë 27.05.2025, bashkëlidhur është vendosur në dispozicion botimi i gazetës i datës 27.05.2026, si dhe në Fletoren Zyrtare nr. 96, të datës 03.06.2025, sipas shkresës nr. 835/2 prot., datë 18.06.2026 të Qendrës së Botimeve Zyrtare.

Gjykata, pas kryerjes së veprimeve paraprake, në respektim të nenit 158/b, paragrafi 2 të KPC vendosi zhvillimin e një seance përgatitore me qëllim dëgjimin e palëve, administrimin e kërkesave procedurale të tyre të cilat mund të paraqiten në këtë moment procedural, si dhe caktimin e rrethit të provave që do të merren në shqyrtim në seancë gjyqësore.

Në seancën gjyqësore të datës 15.06.2026, ora 13:00, gjykata pasi verifikoi prezencën e palëve, konstatoi se u paraqit përfaqësuesi i palës kërkuese Av. Arton Kasaj, si dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, Prokuror Julinda Gjika.

II. Rrethanat e faktit

Nga hetimi i çështjes, i realizuar në seancë gjyqësore, rezultuan të provuara rrethanat e faktit, si më poshtë vijon: se kërkuesja ***** , atësia ***** , amësia Nadire, datëlindja 17.07.1972, vendlindja Vlorë, numër personal H25717098E është nëna e shtetasit Elvis ***** , sipas certifikatës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë

familjare, datë 28.04.2025 të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Nr. 417,
Njësia Administrative Vlorë, Bashkia Vlorë.

Shtetasi Elvis ***** rezulton se është zhdukur që prej datës 17.07.2018, pasi në këtë datë rreth 18:00 ka dalë nga banesa e tij e ndodhur në lagjen “29 Nëntori” dhe ka shkuar tek “Bar Havana”, në afërsi të banesës, pranë shkollës “24 Maji”. Pak çaste më vonë është ngritur nga tavolina. Pasi ka dal nga lokali, në rrugën kryesore e priste një automjet i tipit “Mercedes Benz”, me ngjyrë gri. Elvsi pasi është përshëndetur me drejtuesin e mjetit hipën në makinë dhe makina niset për në drejtim të vendin të quajtur “Albano e Romina”. Më vonë automjeti tip “Mercedes Benz”, me ngjyrë gri, në të cilën kishte hipur shtetasi Elvis ***** është konstatuar në “Lungo Mare”, tek vendi i quajtur “*Kryqëzimi i shtatë pallateve*” dhe mandej drejtohet për nga “Hotel Rexhina”. Më pas makina zhduket në afërsi të kompleksit Oslo, në lagjen “Uji i ftohtë”. Që prej datës 17.07.2018 nuk ka asnjë njoftim apo lajm në lidhje me shtetasin Elvis *****.

Nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë, lidhur me zhdukjen e shtetasit Elvis ***** , është regjistruar procedimi penal nr. 1381/2018 për veprën penale “*Vrasja me paramendim*” dhe “*Fshehja ose asgjesimi i kufomës*”, parashikuar nga nenet 78 dhe 303 i Kodit Penal. Me vendimin e datës 13.06.2019 është ndarë procedimi penal nr. 1381/2018 dhe është regjistruar procedimi penal nr. 973, viti 2019, për veprën penale “*Moskallëzim i krimit*” dhe “*Përkrahja e autorit të krimit*”, parashikuar nga nenet 300 dhe 302 të Kodit Penal. Me vendimin nr. 439, datë 31.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë shtetasi B.Zh është shpallur fajtor për veprat penale “*Moskallëzim i krimit*” dhe “*Përkrahja e autorit të krimit*”, parashikuar nga nenet 300 dhe 302 të Kodit Penal, lidhur me zhdukjen e shtetasit Elvis *****.

III. Legjislacioni i zbatueshëm

Në nenin 375 të KPC parashikohet se: “*Kërkesa për shpalljen e një personi të zhdukur ose të vdekur mund të paraqitet nga çdo person i interesuar, nga noteri, pranë të cilit personi ka redaktuar një testament me akt noterial, apo ka depozituar për ruajtje testamentin ollograf ose testamentin e posaçëm, apo nga prokurori në gjykatën ku ka pasur vendbanimin e fundit personi për të cilin kërkohet shpallja si i tillë*”.

Në nenin 376 të KPC parashikohet se: “*Në kërkesën për shpalljen e një personi të zhdukur ose të vdekur, përveç rrethanave nëpërmjet të cilave bëhet e besueshme zhdukja ose vdekja e tij, tregohet edhe kujdestari ose*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë

përfaqësuesi ligjor i tij, për rastet kur ka të tillë. Në kërkesën për deklarimin e një personi si të vdekur, duhet të tregohen edhe personat që janë ose mund të jenë trashëgimtarë të tij, si dhe gjithë personat e tjerë për të cilët është e ditur që nga ky fakt fitojnë ose humbin të drejta”.

Në nenin 377 të KPC parashikohet se: “Gjykata, brenda dhjetë ditëve nga paraqitja e kërkesës për gjykim, i dërgon një kopje të saj bashkisë ose komunës, ku ka pasur banimin e tij të fundit personi që kërkohet të shpallet i zhdukur ose i vdekur, për ta shpallur në një vend të dukshëm. Kërkesa e mësipërme botohet edhe në Fletoren Zyrtare, si dhe të paktën në një gazetë lokale. Shqyrtimi i çështjes nga gjykata nuk mund të bëhet pa kaluar gjashtë muaj nga shpallja e kërkesës ose botimit të saj në Fletoren Zyrtare”.

Në nenin 378 të KPC parashikohet se: “Gjykata, në shqyrtimin e kërkesës për shpalljen të zhdukur ose të vdekur të një personi, pyet njerëz të afërt të tij, merr të dhëna për këtë person nga bashkia ose komuna, ku ai ka pasur vendbanimin e tij të fundit, si dhe nga çdo burim tjetër që mund të japë lajme për këtë person”.

Në nenin 379 të KPC parashikohet se: “Në shqyrtimin e kërkesës për ndryshimin ose prishjen e vendimit që ka deklaruar një person si të vdekur të thirren personat që kishin kërkuar deklarimin e vdekjes dhe personat që kanë fituar të drejta nga deklarimi i vdekjes”.

Në nenin 380 të KPC parashikohet se: “Gjykata vendos për shpalljen e një personi të zhdukur apo të vdekur, pasi të ketë dëgjuar edhe personat që përmenden në nenin 375 e 376 të këtij Kodi, si dhe prokurorin. Gjykata urdhëron botimin e shkurtimit të vendimit në Fletoren Zyrtare ose të paktën në një gazetë lokale të caktuar prej saj ose në një mënyrë tjetër publikimi që do ta quajë të dobishme. Gjykata mund të marrë masa për sigurimin e pasurisë trashëgimore. Ajo autorizon dhomën e noterisë në nivel vendor, që mbulon njësinë vendore të vendbanimit të fundit të të shpallurit të zhdukur ose të vdekur, ose noterin, pranë të cilit është redaktuar testamenti me akt noterial, apo është depozituar për ruajtje testamenti ollograf ose testamenti i posaçëm, që të bëjë inventarin e pasurisë së trashëgimlënësit. Dhoma e noterisë në nivel vendor cakton një noter për të bërë inventarin e pasurisë së trashëgimlënësit. Noteri në këtë rast duhet të caktojë një person si ruajtës të pasurisë trashëgimore deri në çeljen e dëshmisë së trashëgimisë”.

Në nenin 381 të KPC parashikohet se: “Vendimi i gjykatës, që e deklaron një person të zhdukur ose të vdekur, i dërgohet për regjistrim zyrës së gjendjes civile në të cilën ai ka qenë i regjistruar, pasi të sigurohet se është bërë publikimi i tij sipas dispozitës së mësipërme”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë

Në nenin 15 të KC parashikohet se: *“Personi që mungon nga vendi i banimit ose i vendqëndrimit të fundit të tij dhe për të cilin nuk ka lajme për më shumë se dy vjet, me kërkesën e çdo të interesuari mund të shpallet i zhdukur me vendim të gjykatës. Kur dita e lajmeve të fundit nuk mund të caktohet, afati i mësipërm fillon nga dita e parë e muajit pasardhës në të cilin janë marrë lajmet e fundit. Kur muaji nuk mund të caktohet, afati fillon nga dita 1 janar e vitit të mëpasëm”.*

Në nenin 16 të KC parashikohet se: *“Me shpalljen e zhdukjes së një personi, për administrimin e pasurisë së tij caktohet një kujdestar. Vendimi i gjykatës, me të cilin një person është shpallur i zhdukur, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i dërgohet për regjistrim zyrës përkatëse të gjendjes civile”.*

IV. Vlerësimi i Gjykatës

A. Lidhur me gjykimin e çështjes

Padia (kërkesa) përbën mjetin procedural me të cilin pala paditëse (kërkuese) vë në lëvizje gjykatën, kur pretendon se ka një të drejtë subjektive, për të njohur apo mbrojtur, e cila gjen mbështetje në të drejtën pozitive, si nga pikëpamja materiale ashtu edhe nga ajo procedurale, element thlebësor për të garantuar të drejtën për akses në gjykatë, parashikuar nga neni 42 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 6 i KEDNJ-së (*Për më shumë lidhur me të drejtën për akses shih jurisprudencën e GJEDNJ-së Beles et autres c. République tchèque, p. 49; Golder c. Royaume-Uni, p. 36 dhe Gjykata e Lartë, Kolegji Administrativ, Vendimi Njësues nr. 00-2025-1483(1), datë 13.01.2025*). Vetëm palët mund të vënë në lëvizje gjykatën, përveç kur ligji parashikon ndryshe (neni 2 i KPRC). Parimi i iniciativës u njeh të drejtën palëve për të kërkuar fillimin e një procesi gjyqësor dhe për të disponuar në lidhje me padinë në mënyrë individuale.

Gjykata, në përfundim të hetimit gjyqësor, pasi analizoi rrethanat e faktit, mori, administroi dhe vlerësoi provat shkresore, dokumentare dhe ato me dëshmitarë, pasi dëgjoi pretendimet e palëve, si dhe pasi bëri një interpretim të drejtë të dispozitave ligjore të zbatueshme në rastin konkret, vlerëson se kërkesa e paraqitur është e bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë ajo duhet të pranohet në tërësinë e saj.

Gjatë gjyqimit u provua se shtetasi Elvis ***** ka humbur kontaktet



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë

me familjarët prej datës 17.07.2018 dhe prej kësaj date nga familjarët e tij nuk ka asnjë informacion lidhur me të. Bazuar në nenin 378 të KPC ky fakt u provua gjatë gjykimit nëpërmjet provave të mëposhtme:

- Nëpërmjet vendimit nr. 439, datë 31.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë u provua se shtetasi B.Zh është shpallur fajtor për veprat penale "Moskallëzim i krimi" dhe "Përkrahja e autorit të krimi", parashikuar nga nenet 300 dhe 302 të Kodit Penal, lidhur me zhdukjen e shtetasit Elvis *****.

- Nëpërmjet shkresës nr. 4282/1 prot., datë 12.03.2026 të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve u provua se: *"shtetasi Elvis ***** i datëlindjes 03.06.1994 aktualisht nuk ndodhet dhe nuk figuron të ketë kryer dënim në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale"*.

- Nëpërmjet shkresave nr. 1780/1 prot., datë 28.04.2026 dhe nr. 1032/1 prot., datë 28.04.2026 të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë janë depozituar sistemi "TIMS" i shtetasit Elvis ***** (Palla), nëpërmjet të cilit u provua se ka hyrë për herë të fundit në territorin e Republikës së Shqipërisë në datë 05.07.2018 dhe prej kësaj date nuk ka më dalje.

- Nëpërmjet shkresave nr. 742/1 prot., datë 03.04.2026 dhe nr. 513/1 prot., datë 10.03.2026 të Drejtorisë Vendore për Kufirin dhe Migracionin Vlorë u prova se shtetasi Elvis ***** (Palla) ka hyrë për herë të fundit në territorin e Republikës së Shqipërisë në datë 05.07.2018 dhe nuk ka dalje pas kësaj date.

- Nëpërmjet shkresës nr. 9965 KL Prot., datë 04.05.2026 Departamenti për Marrëdhëniet Ndërkombëtare, Drejtoria e Interpolit u prova se: *"shtetasi Elvis ***** alias Elvis Palla është shpallur në kërkim ndërkombëtar si shtetas i humbur nga Interpol Tirana në datë 29.09.2019, bazuar në kërkesën për shpalljen në kërkim ndërkombëtar të Drejtorisë Vendore të Policisë Vlorë me nr. 1435 Prot., datë 19.09.2019. Nga verifikimi në sistemin e-ASF të Interpol, Arkivin Elektronik të Drejtorisë së Interpolit (DIR) dhe dosjes fizike, nuk disponohen të dhëna për aktivitet kriminal jashtë vendit apo për vendndodhjen e shtetasit të mësipërm"*.

- Nëpërmjet shkresës nr. 220 prot., datë 06.03.2026 së Gjendjes Civile, Bashkia Vlorë u provua se: *"Elvis Krenar ***** lindur dt. 03.06.1994 në Vlorë me nr. pers. J40603093S. 1- Figuron i regjistruar sipas adresës së mëposhtme Bashkia Vlorë, Rr. "Zef Skiroi", Nd.44, H.1, KP.9401, në përbërje familjare vetëm me nënën znj. ***** ***** 2- Me Akt martesë nr. 9, datë 01.02.2018 të Zgjc 3, Vlorë ka lidhur martesë me shtetasen Erilda Ilia Palla, dhe kanë mbajtur mbiemrin e përbashkët Palla. 3. Me Vendim nr. 830, datë 14.09.2020 të Gjykatës së*



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë

*Rrethit Gjyqësor Vlorë, ka zgjidhur martesën dhe ka marrë mbiemrin para martese *****. 4- Ka aplikuar për letërnjoftim elektronik ID datë 15.09.2011 dhe datë 12.02.2018'.*

- Nëpërmjet shkresës nr. 3763/1 prot., datë 09.04.2026 Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Vlorë, u prova se: *"Nga verifikimi i kryer në sistemin elektronik EXEL të të vetëpunësuarve në bujqësi për periudhën 01.10.1993- 08.04.2026 dhe verifikimin në formatin elektronik CMIS për sigurimin vullnetar për periudhën 01.10.1993- 08.04.2026 personi i mëposhtëm: 1. Elvis ***** nuk figuron në asnjë system të Degës së Kontributeve".*

- Gjithashtu, nëpërmjet CD, regjistrim audio dhe video u prova se shtetasi Elvis ***** në datë 17.07.2018 ka hipur në një automjet të tipit "Mercedes Benz", fakt i cili pasqyrohet edhe në vendimit nr. 439, datë 31.10.2019 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

Në kuadër të hetimit gjyqësor të plotë, bazuar në nenin 213, 231, 232 e vijues, si dhe nenit 378 të KPC, Gjykata lejoi pyetjen në cilësinë e dëshmitarit të të afërmit të shtetasit Elvis ***** , konkretisht shtetasit Miranda Bufaj, e cila është emta (halla), Erald ***** , i cili është vëllai dhe Julian Ferko, kushërirri (djali ungjit-dajos).

Dëshmitarja Miranda Bufaj në seancë gjyqësore deklaroi se: *"Në datë 17.07.2017 e thirrën dhe doli tek lokali poshtë pallatit , hipi në një makinë për 5 minuta dhe nuk u gjet më, humbi. Nuk e mbaj mend 2017 apo 2018 se është dhe nipi jam e emocionuar, por e di që në 17 korrik ka pas datëlindjen e të ëmës. Kemi kërkuar, nuk kemi pasur lajm, asnjë njoftim se kush e mori".*

Dëshmitari Erald ***** në seancë gjyqësore deklaroi se: *"Ka qenë data 17.07.2017 kishim festën e mamasë, kishte datëlindjen mamaja dhe kishim organizuar një festë, ka dal vëllai nga shtëpia dhe nuk e kemi parë më, kemi vajtur në polici nuk kemi marr përgjigje akoma. Di që ka qenë duke pirë kafe tek lokali i lagjes, ka ardhur një makinë, nuk e di kush është ai person që e ka takuar. Dhe diçka për saktësim, saktësojë ka qenë data 17.07.2018".*

Dëshmitari Julian Ferko në seancë gjyqësore deklaroi se: *"Është djali dajos, atë ditë që doli nga shtëpia nuk erdhi më".*

Për sa më sipër, gjykata nga ana e saj çmon se referuar provave shkresore të administruara, CD (regjistrimit audio dhe video), thëniet e dëshmitarëve, u provua se për shtetasin Elvis ***** nuk ka informacione zyrtare për vendndodhjen e tij dhe për faktin nëse është gjallë apo i vdekur. Po kështu u provua se ky shtetas mungon në vendbanimn e tij të fundit për më tepër se dy vjet. Ai është larguar nga banesa e tij në datë 17.07.2018 dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë

prej asaj date nuk ka asnjë infomacion për vendndodhjen e tij. Në këto kushte për gjykatën krijohet bindja se ky shtetas rezulton i zhdukur.

Në nenin 16 të KC parashikohet se me shpalljen e zhdukjes së një personi, për administrimin e pasurisë së tij caktohet një kujdestar. Referuar fakteve të parashtruara nga kërkuësja dhe qëllimit të paraqitjes së kërkesës nga ana e saj, çmon të caktoje atë si kujdestare ligjore për administrimin e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme të djalit saj Elvis *****.

Bazuar në nenin 380/1 dhe 381 të KPC një kopje e këtij vendimi pasi të marrë formë të prerë të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare, pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, si dhe pranë Zyrës së Gjendjes Civile 417, Njësia Administrative Vlorë, Bashkia Vlorë, për të bërë veprimet përkatëse.

B. Lidhur me të drejtën e ankimit

Në lidhje me të drejtën e ankimit kundër vendimit përfundimtar në nenin 443, të Kodit të Procedurës Civile parashikohet se afati i ankimit është 15 (pesëmbëdhjetë) ditë. Sipas nenit 308, të Kodit të Procedurës Civile, gjykata mund të shpallë vetëm dispozitivin e vendimit përfundimtar duke e dorëzuar atë të arsyetuar në sekretari ose t'a shpallë atë të arsyetuar.

Afati i ankimit nis pikërisht nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar, sipas parashikimeve të nenit 444 të Kodit të Procedurës Civile.

C. Lidhur me shpenzimet gjyqësore

Lidhur me shpenzimet gjyqësore të kryera gjatë gjykimit, në zbatim të neneve 105, 106, dhe 107/2 të KPC, Gjykata duke marrë në konsideratë llojin e gjykimit pa palë kundërshtare, vlerëson se shpenzimet gjyqësore, të përbëra nga taksa gjyqësore, njoftimet e palëve në gjykim, si dhe shpenzimet e tjera të kryera gjatë gjykimit të mbeten siç janë kryer.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata, në zbatim të neneve 16, 126, 306-310, dhe 375-381 të Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë;;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë

Për keto arsye:

Baza Ligjore:x

Vendosi:

1. Pranimin e kërkesës. <?xml:namespace prefix = "o"
2. Shpalljen e zhdukjes së shtetasit Elvis *****, atësia Krenar, amësia *****, datëlindja 03.06.1994, vendlindja Vlorë, numër personal J40603093S.
3. Caktimin e shtetasese *****, atësia *****, amësia Nadire, datëlindja 17.07.1972, vendlindja Vlorë, numër personal H25717098W, si kujdestare për administrimin e pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme në emër të shtetasit Elvis *****.
4. Një kopje e këtij vendimi pasi të marrë formë të prerë të dërgohet për botim në Fletoren Zyrtare, pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare, si dhe të dërgohet pranë Zyrës së Gjendjes Civile 417, Njësia Administrative Vlorë, Bashkia Vlorë, për të bërë veprimet përkatëse.
5. Shpenzimet gjyqësore siç janë kryer.
6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve duke filluar ky afat nga e nesërmja enjftimit të vendimit të arsyetuar.

Ky dokument është marrë nga www.gjykata.gov.al. Ai ka vlerë të plotë informuese, por nuk shërben si dokument zyrtar. Ky i fundit lëshohet nga autoritetet përkatëse.